



BULETINI

2021
2022

Shtrirja e Forumit Rinor Islam



SHKUP

Adresa:
Rr. Çairska nr. 1,
1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

KUMANOVË

Adresa:
Rr. Karl Marks nr.60
1300 Kumanovë, Maqedonia e Veriut

TETOVË

Adresa:
Rr. Jane Sandanski, 64
1220 - Tetovë, Maqedonia e Veriut

GOSTIVAR

Adresa:
Rr. Sedek Kostoski 19,
1230 Gostivar, Maqedonia e Veriut

KËRÇOVË

Adresa:
Qendra Tregtare H/R Arabella
1300 Kërçovë, Maqedonia e Veriut

PRILEP

Adresa:
fsh. Cërnilishtë
7516 Prilep, Maqedonia e Veriut



Mr. Xhabir Emini

kryetar

I nderuar lexues

Para jush keni buletin i cili bën përshkrimin e punës së Forumit Rinor Islam duke filluar nga fundi i vitit 2020, atëherë edhe kur ndodhën zgjedhjet për fillimin e mandatit të ri të veprimtarisë katërvjeçare në periudhën që pason pra deri në dhjetor të 2024. Fillimi i këtij mandati ishte një fillim shumë i vështirë që në vete ngërthente shumë sfida në mesin e të cilave do të veçoja sfidën e pandemisë COVID 19 e cila kishte arritur kulmin e ndikimit të saj edhe atë në aspekt shëndetësor, ekonomik, shpirtëror dhe shoqëror.

Rinia, jo që nuk ka patur telashe të ndryshme edhe para kësaj periudhe, por ata ishin thelluar edhe më shumë sepse ishte periudha kur nga ndjekja e mësimit me prezencë fizike kaluan në metoda të reja të arsimit në distancë nëpërmjet platformave të ndryshme, gjendje kjo e cila ndikoi mjaft në ngritjen dhe edukimin e tyre arsimor. U përkeqësua edhe gjendja financiare, shtresa punëtore u futën në krizë shkaku i mbylljes së shumë firmave. Imune nga kjo situatë nuk ishte as shoqëria civile përfshirë këtu edhe Forumin Rinor Islam, organizatë kjo e cila u mundua që të bëjë menaxhimin e kësaj situatë të palakmueshme. Duke qenë fleksibile në veprimtarinë e vet, kaloi nga aktivitetet me prezencë fizike në ato me distancë, me qëllim që të rinjtë të mos humbisnin elanin dhe dëshirën për punë dhe veprimtari rinore. Ne u përpoqëm që disa aktivitete t'i realizojmë në formë të ndryshme në platforma online. Në ndërkohë ishim duke bërë formimin dhe strukturimin e ekipit të punës, krejt kjo për t'u bërë ballë sfidave dhe telasheve që po kalonim.

Viti 2021 ishte një vit paksa më i relaksuar ku filluam me realizimin e aktiviteteve në ambiente të hapura

dhe me masa mbrojtëse restriktive, kështu duke me numër të kufizuar dhe me distancë, ne filluam me disa aktivitete, të këtij lloji që filluan ngadalë të grumbullojnë anëtarët dhe aktivistë të cilët ishin lodhur nga periudha që po linim pas. Aktiviteti i parë më madhor pas kësaj periudhe ishte "Mbrëmja Kuranore" që u realizua në sheshin "Skenderbeu" në Shkup, në muajin e bekuar Ramazan, aktivitet ky i cili mbledhi shumë të pranishëm me çka vërehej etja e tyre për organizime të tilla. Në po të njejtin vend u realizua edhe manifestimi tradicional "Në gjurmët e më të mirëve" me rastin e vitit të ri të kalendarit islam, Hixhri 1443, ku vazhdoi tradita e shpalljes së nxënësve të dalluar, studentëve të dalluar, shkencëtarit të ri, hafizit më të ri si dhe personaliteteve të vitit me qëllim të mos ndërprerjes së traditës së ndërtuar për 20 vite me radhë.

Vitin 2022 e filluam me më shumë elan dhe energji, edhe atë duke filluar me "Staff retreat" dhe kuvendin në të cilin miratuam planin akcional për 2022, nga i cili buruan disa aktivitete që do të bënin një ngritje serioze të kurbllës së aktiviteteve dhe aktivizmit rinor në gjashtë qytetet ku vepron organizata jonë. Platforma "Mozaiku Rinor" dhe Akademia Rinore "Mendimi" ishin dy aktivitete që ngërthyen në vete një program aftësues, edukativ dhe rekreativ për të rinjtë. Rikthyem bursat për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme, aktivitetet rekreative dhe edukative si: pikniqet, kampingjet, seminarët verore, ekskurzionet dhe vizitat në vende të ndryshme. Në tetor të këtij viti u përurua edhe objekti i ri i Forumit Rinor Islam, Qendra Rinore në Shkup, ngjarje kjo mjaft e rëndësishme dhe madhore për FRI si një nektar të trashëguar nga mandati paraprak. Gjatë kësaj periudhe nuk kanë

munguar vizitat dhe bashkëpunimet edhe me institucione tjera si ato lokale, qendrore, universitete, shkolla, OJQ vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, ku janë shkëmbyer përveç përvojave edhe aktivitete të ndryshme. Këtë vit realizuam edhe manifestimin tradicional "Në Gjurmët e më të mirëve" një aktivitet që morri formën paraprake si në realizim ashtu edhe në përfshirje të personaliteteve të dekoruar.

Ishte ky një fillim me plot sfida, por edhe me shumë mesazhe dhe mësim për ne si FRI, sepse na bëri të kuptojmë se nëse ka dëshirë, planifikim, besim dhe mbështetje në Zot, atëherë nuk ka gjë që nuk është e mundur. Na mësoi se sa të rëndësishme janë aktivitetet rinore dhe aktivizmi i të rinjëve me punë që i avancojnë në aspekte të ndryshme. Kjo periudhë ishte nxitëse edhe përcaktimit të motos së mandatit: "FLEKSIBILITET, PËRKUSHTIM, ARRITJE" që për ne ngërthen një mësim të madh nga periudha që lam pas. E lus Allahun xh.sh. që ta shpërblejë mundin dhe sakrificën e të gjithëve që na përkrahën dhe na përkrahin duke filluar nga anëtarët, aktivistët, donatorët dhe qytetarët që ishin afër nesh në formë të ndryshme gjatë këtyre dy viteve.

Allahu xh.sh. e ndriçoftë këtë rrugë të shenjtë.

Amin!

VIZIONI YNË

Forumi Rinor Islam të jetë udhëheqës në fushën e veprimtarisë rinore, shembull i organizatës së suksesshme në zhvillimin e gjithëmbarshtëm shpirtëror, material, kulturor dhe moral të shoqërisë; organizatë e afirmuar në vend dhe arenën ndërkombëtare në hap me proceset integruese.

MISIONI YNË

Promovimi dhe kultivimi i vlerave universale Islame dhe njerëzore, mbrojtja e të rinjëve nga devijimet si dhe ngritja dhe aftësimi i tyre.

POLITIKAT E FORUMI RINOR ISLAM

Fokusimi në çështjet prioritare
Maturia dhe gradualiteti në veprim
Disciplina në realizimin e detyrave
Dialogu dhe partneriteti
Mbrojtja e identitetit kulturor
Fuqizimi i të rinjëve

VLERAT E FORUMI RINOR ISLAM

Besimi
Përpikshmëria
Mesataria
Vetëmohimi
Objektiviteti
Uniteti
Toleranca
Mirëkuptimi
Bashkëpunimi
Puna institucionale


QËLLIMET STRATEGJIKE

Avancimi i punës rinore
Avancimi i punës edukative
Ngritja e kapaciteteve kadrovike dhe institucionale
Promovimi në media dhe opinionin publik
Bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare, akademike, arsimore, OJQ dhe mediume
Qëndrueshmëria financiare e FRI-së



FORUMI RINOR ISLAM

ORGANOGRAMI





MR. XHABIR EMINI
KRYETAR



ABDULHAMID MUSTAFA
SEKRETAR GJENERAL
&
PËRGJEGJËS
DEP. PËR ZHVILLIM TË BRENDSHËM



ZULJETA FETAJ
NËNKRYETARE



MR. VULLNET SELMANI
NËNKRYETAR
&
PËRGJEGJËS
ZYRA PËR FINANCA DHE PROJEKTE



ERDUAN KURTISHI
KRYETAR - KUMANOVË
&
PËRGJEGJËS
DEP. I FUSHATAVE



AFRIM DEMIRI
KRYETAR - SHKUP



MEVLAN ABAZI
KRYETAR - TETOVË
&
PËRGJEGJËS
DEP. I EDUKIMIT



ZURIJET SULEJMANI
KRYETAR - GOSTIVAR



SHUKRI SADIKU
KRYETAR - KËRÇOVË



VETON IBRAHIMI
KRYETAR - PRILEP




MR. BURHANEDIN NUHIJU
ANËTAR



ZEQIR ESATI
ANËTAR



ERMIRA IDRIZI
ANËTARE



EMINE ALIMI
PËRGJEGJËSE
DEP. PËR TË RINJ



VALMIRA ABAZI
ANËTARE



EBRAR SHERIFI
PËRGJEGJËS
ZYRA PËR MARRËDHËNIE
ME PUBLIKUN



BULETINI
2021

in gjuhën
Muhamedin
(alejhi selam)

Java e Pejgamberit (alejhi selam)
Emisione live me
Hasan Baftjari

Tema: *Themelet mbi të cilat e ndërtoi Muhammedi alejhi selam civilizimin islam*
Ligjerues: Prof. Sali Shahsivari

Na ndiqni
Data: 11.11.2020 (e mërkurë)
Ora: 21:00
Livestream në facebook
Forumi Rinor Islam - Islamic Youth Forum

Emisione live
"Melhemet e Zembrës"
me Hasan Baftjari

Mysafir: **Halil Avdulli**,
E enjte, ora 20:00.
Drejtperdrejt në:

Forumi Rinor Islam - Islamic Youth Forum



AKSIONI "SHPËTO JETË, DHURO GJAK" NË KËRÇOVË

Në janar të vitit 2021, FRI - Kërçovë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe Institutin e Transfuziologjisë realizoi aksion për dhurim të gjakut. Ky ishte një nga aksionet më të suksesshme të këtij lloji në qytetin e Kërçovës.

TA NJOHIM MUHAMEDIN (ALEJHI SELAM)

Kampanja "Ta njohim Muhamedin a.s." u realizua gjatë tetorit të vitit 2020. Në bashkëveprim me situatën që solli pandemia u realizuan emisionet "Java e Pejgamberit" me hoxhën Hasan Baftjari, dhe aktiviteti "Të tjerët për Muhamedin a.s." nëpërmjet rrjeteve sociale.

EMISIONET "MELHEMET E ZEMRËS"

Emisionet online "Melhemet e zembrës" janë realizuar gjatë dhjetorit të vitit 2020, kur edhe mundësitë për realizimin e takimeve fizike ishin të pamundura. Emisionet "Melhemet e zembrës" janë realizuar nëpërmjet platformës Zoom, për tu transmetuar drejtpërdrejt në rrjetet sociale. Hoxhë Hasan Baftjari në këto emisione ka diskutuar tema të ndryshme me imamë dhe intelektualë nga të gjitha trojet shqiptare.





FRI ME ZYRA TË REJA NË PRILEP

Janari i vitit 2021 gjeti degën e Forumit Rinor Islam në Prilep me zyra të reja, të cilat do të shërbenin për realizimin e aktiviteteve në të ardhmen.

Me rastin e hapjes solemne u mbajt një ligjëratë dhe një koktej modest.



21 Shkurti Dita ndërkombëtare e Studentit

Edhe historia më e re dhe aktualiteti i sotëm anë e mbanë botës, tregojnë për ngjarje e zhvillime të cilat si promotorë kryesorë kanë studentët. Dhe si të tillë ata, studentët, duhet të mbeten gjithmonë, duke pasur si vizion Fjalën e Zotit të Madhërishtëm në Kur'anin Fisnik:

"... All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre..." (Rad: 11)

Të nderuar studentë, ju jeni forca dhe shpirti i shoqërisë, andaj kuptoni peshën që keni dhe bëhuni forca e ndryshimeve pozitive në shoqëri, merreni fllaurin e progresivitetit shkencor, ekonomik, social etj.

Xhabir Emmini, kryetar
Forumit Rinor Islam

DITA NDËRKOMBËTARE E STUDENTIT DHE DITA BOTËRORE E MBULESËS

Me rastin e 21 shkurtit, Ditës Ndërkombëtare të Studentit, kryetari i FRI - Mr. Xhabir Emmini, përgatiti një shkrim motivues i cili u postua në rrjetet sociale. Nënkryetarja e FRI, Zuljeta Fetaovska, me rasin e 1 shkurtit, Ditës Botërore të Mbulesës gjithashtu përgatiti një shkrim që u postua në rrjetet sociale.



FRI PRANOI DONACION PREJ 12 MIJË MASKA NGA ALIM GROUP

Duke marrë parasysh kushtet e pandemisë dhe nevojën për masa mbrojtëse, FRI pranoi donacion prej 12 mijë maskave nga Alim Group, të cilat maska përdoren për marrjen e masave mbrojtëse gjatë aktiviteteve të FRI.



“RAMAZANI, KTHIM NË VETE”

Aktivitetet të shumta u realizuan edhe këtë vit, por me kujdes të veçantë për ruajtjen e shëndetit publik dhe respektimin e masave kufizuese. Një pjesë e madhe e aktiviteteve u realizuan në formën elektronike, në platforma të ndryshme.

Manifestimi “Mirë se erdhe muaji Ramazan” u realizua në formën online, duke u transmetuar në kanalet e FRI-së në Youtube dhe Facebook.

Në qytetin e Tetovës dhe Prilepit, në shenjë të mirëseardhjes së muajit të shenjtë u realizua edhe shpërndarja e ëmbëlsirave, urimit të Ramazanit dhe lutjeve të iftarit dhe syfyrit për banorët e atyre vendeve. Ndërsa në qytetin e Kumanovës u realizua vendosja e banderolave në disa vende të ndryshme të qytetit.

Në gjashtë televizione lokale, dy portale elektronike jovendore si dhe në kanalet e FRI-së u transmetuan 15 këshillat e shkurtëra të realizuara nga FRI me hoxxhallarë, anëtarë të FRI-së, dhe aktivistë të shoqërisë civile, me titull “Melhemet e Ramazanit”.



Dëgjuesit e Radio Jon patën mundësin të dëgjojnë edhe "30 mësimet për agjëruesin" nga autori Aid el Karni të përgatitura nga FRI.

"Shporta e Ramazanit" këtë vit u realizua në qytetin e Kumanovës, Tetovës dhe Prilepit. Bamirës të shumtë patën rastin të kontribuojnë në mbledhjen e shportave, në pikat e mbledhjes në tre qytetet e lartpërmendura si dhe nëpërmjet platformës Launchgood. Mbi 1500 shporta të Ramazanit u shpërndanë tek nevojtarët, skamnorët e jetimët përgjatë muajit të Ramazanit në po të njëjtat qytete. Risi e këtij viti ishte "Ajeti im i preferuar!" me katër video inçizime të realizuara nga aktivistë të FRI-së dhe të transmetuara çdo të premte në kanalet e FRI-së, si dhe memorizimi i sures Mulk, "Mulk challenge", e cila u realizua në aplikacionin WhatsApp duke ju dërguar çdo ditë nga një ajet pjesëmarrësve.

Aktivitet risi ishte edhe "Opinionet e Ramazanit", në të cilën shumë anëtar dhe aktivist paraqitën opinionet e tyre mbi ndjenjat që ju ofron muaji i Ramazanit.

Pjesë e aktiviteteve të muajit të Ramazanit ishin edhe ligjëratat e shumta të realizuara nëpërmjet platformave online me transmetime të drejtpërdrejta në Facebook.

Në qytetin e Kumanovës u realizua edhe mukabele (lexim i Kuranit) nëpërmjet platëformës Zoom, me hoxhë Zeqir Esati.

Nën zërin e bukur të hfz. Xhemail Nuhijut dhe hfz. Egzon Ibrahimit u realizua edhe Mbrëmja Kurane në sheshin Skenderbeu të qytetit të Shkupit. Pjesë e programit ishin edhe fjalimet nga Kryetari i FRI-Shkup dhe Kryetari i komunës Çair.

Në natën e Bajramit, në qytetin e Kumanovës u bë edhe lansimi i fishekzjarrëve me qëllim njoftimi të festës së Bajramit. Ndërsa në qytetin e Tetovës u shpërndan dhurata Bajrami për kalimtarët e rastit.

Çdo ditë të muajit të Ramazanit janë postuar edhe përkujtues me hadithe profetike, ajete kuranore për muajin Ramazan, përkujtim për kohën e iftarit, syfryrit dhe kohës së namazeve si dhe lutje në kohën e iftarit!





VIZITË NË REPUBLIKËN E TURQISË

Në qershor të vitit 2021 një delegacion i Forumit Rinor Islam, udhëhequr nga kryetari, Xhabir Emini, realizuan një sërë vizitash në Republikën e Turqisë. Ato vizituan organizatat si IHH, Besader, Tugva, Maarif, İlim Yayma etj... me të cilat FRI ka një bashkëpunim konstruktiv.



SHËTITJE ME NXËNËSIT E KURSIT TË KURANIT

Me rastin e përfundimit të vitit akademik, nxënësit që ndoqën kursin e Kuranit në qytetin e Kërçovës, së bashku me mësuesen e tyre realizuan shëtitje në qytetin e Strugës. Ato vizituan qytetin, xhamitë dhe patën mundësi që së bashku të eksplorojnë liqenin e Ohrit.

FLEKSIBILITET, PËRKUSHTIM, ARRITJE

Fillimi i mandatit të ri, bëri edhe përditësimin e motos që Forumit Rinor Islam. Motoja e këtij mandati u zgjodh të jetë: "Fleksibilitet, Përkushtim, Arritje".



FLEKSIBILITET PËRKUSHTIM ARRITJE



FORUMI RINOR ISLAM

www.fri.org.mk





FESTA E BAJRAMIT NË KUMANOVË


Për të kremtuar festën e Kurban Bajramit aktivistët dhe anëtarë e FRI në Kumanovë ndanë ëmbëlsira dhe fletëurime për fëmijët në sheshin e Kumanovës.



KAMPI VEROR NË TURQI

Në gusht të vitit 2021, Forumi Rinor Islam, realizoi kamp veror me anëtarët dhe aktivistët e FRI nga të gjitha degët e organizatës. Si pjesë e këtij kampi veror u bënë vizita të ndryshme në qytetin e Stambollit, duke ju dhënë mundësinë të rinjve tanë të eksplorojnë Stambollin.





**FLEKSIBILITET
PËRKUSHTIM
ARRITJE**

KONKURS

(Për ndarjen e bursave për studentë dhe shkollarë të mesëm për vitin akademik 2021/22)

APLIKIMI

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë studentët e rregullt (deri diplomik) shtetas të RMV, që studiojnë në ndonjë prej Universiteteve Shtetërore në RMV, Universitetin e Evropës Juglindore, Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik, Fakultetin e Shkencave Islame si dhe shkollatë të mesëm shtetas të RMV që mësojnë në RMV.

KUSHTET TË CILAT DUHET TË PLOTËSOJË APLIKUESIJA:

- Nota mesatare për student 8.5
- Nota mesatare për nxënës 5.0
- Studenti të mos ketë përsëritur asnjë vit (të mos ketë rirregjistruar katorrin me përjashtim në rastet specifike të cilat duhet t'i vlerësojë komisioni përkatës për këtë qëshje).
- Të mos jetë shfrytëzues i bursave që ndahen nga institucione të tjera.
- Drejtimet deficiare (të vlerësura si të tilla nga komisioni i degës përkatëse) do të kenë përparësi.
- Nxënësit të cilët mësojnë jashtë qytetit të lindjes (vendbanimit) do të kenë përparësi.

DOKUMENTACIONI I DUHUR PËR APLIKIM:

- Fotografi.
- CV (biografi).
- Letërnjoftimi (fotokopje).
- Indeksi (fotokopje) faqet 1-2 dhe notat ose transkriptet.
- Dëftese e vitit të fundit për nxënësin (fotokopje).
- Vërtetim prej fakultetit se jeni student/e i/e rregullt.
- Dëftese të vitit katërt për studentët që kanë regjistruar vitin e parë të studimeve.
- Vërtetim për regjistrimin e semestrit të fundit.
- Vërtetim nëse merr ndihmë sociale.
- Plotësimi i formularit (për të dhënat personale) nga Forumi Rinor Islam.

AFATI I DORËZIMIT (PRANIMIT) TË DOKUMENTEVE BËHET PREJ 02.09.2021 DERI ME 22.09.2021, NUMRI I BURSAVE ËSHTË I KUFIZUAR.
DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT BËHET PERSONALISHT NGA APLIKUESI ME DOKUMENT IDENTIFIKIMI.
PËRÇIJA PËR PRANIM DO TË BËHET NË AFAT PREJ 15 DITËSH NGA DITA E SKADIMIT TË AFATIT TË DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT.

VËREJTJE:
STUDENTËT/NXËNËSIT QË NUK DO TA KETË TË KOMPLETUAR DOKUMENTACIONIN NUK DO TË MERRET PARASYSH APLIKIMI.

DORËZIMI I DOKUMENTEVE TË BËHET NË ADRESAT E DEGËVE TË FORUMIT RINOR ISLAM NË:

Shkup: Zyra e degës së Shkupit, adresa: Qendra Tregtare Mavrovosja kati 1; Mob: 071 884 791
Kumanovë: Zyra e degës së Kumanovës, adresa: Rr. Karl Marks nr. 60, Mob: 070 661 377
Tetovë: Zyra e degës së Tetovës, adresa: Rr. Jane Sandanski nr. 64, Mob: 071 543 565
Gostivar: Mob: 071 913 941
Kërçovë: Zyra e degës së Kërçovës, adresa: HVR Arabella, kati 1 2-të, mob: 070 615 233
Prilep: Zyra e degës së Prilepit, adresa fsh. Černištitë, mob: 071 440 710

Orari i paraqitjes në numrat e lartëshnuar dhe dorëzimit të dokumenteve gjatë ditëve të punës në adresat e lartëshnuara prej: 11:00-15:00.

DEPARTAMENTI PËR TË RINJ

www.fri.org.mk Rr. Čarska, nr.1
 info@fri.org.mk Shkup, Maqedonia e Veriut

SHKOLLA EDUKATIVE “HAXHI NAZIM XHAFFERI”

Aktivitetet edukative dhe ato të mësimt të Kuranit në qytetin e Kërçovës morën një frymë tjetër. Në degën e Kërçovës u bë hapja solemne e shkollës edukative “Haxhi Nazim Xhaferri”, ku në mënyrë sistematike mësohen shkronjat e Kuranit Famëlartë dhe mësimbesimi.



BURSAT PËR NXËNËS DHE STUDENTË

Për vitin akademik 2021/22 Forumi Rinor Islam hapi konkurs për ndarjen e bursave nga të cilat do të përfitonin nxënësit dhe studentët nga qytete të ndryshme.



FRI – SHKUP ZGJODHI KRYETARIN E RI

Forumi Rinor Islam - Dega Shkup mbajti kuvendin e jashtëzakonshëm, në të cilin u diskutua dhe miratua raporti i aktiviteteve të realizuara gjatë vitit. Kryetari Fuat Shabani raportoi para kuvendarëve edhe raportin financiar, i cili u miratua nga kuvendarët.

Pas dorëheqjes së dorëzuar nga kryetari në largim, kuvendarët zgjodhën edhe kryetarin i ri i degës së FRI në Shkup. Kryetari i ri që zgjodhi kuvendi ishte Afrim Demiri.





BULETINI
2022



AKTIVITETE REKREATIVE

FRI organizon edhe aktivite të natyrës rekreative me të rinjtë që janë pjesë e projekteve dhe aktivitetëve tona. Këtu mund të përmendim: ecjen në majën Vodno, ekskursioni me nxënësit e shkollës edukative "Haxhi Nazim Xhaferri" në Qendrën Rekreative "Saraj", pikniku i përbashkët me nxënësit e projekteve dhe aktivistët, kampingu në fshatin Patishkë, shëtitje njëditore në Kodrën e Diellit me nxënësit e projektit "Eureka".



TAKIME, LIGJËRATA DHE TRAJNIME TË NDRYSHME

Takimet, ligjëratat dhe aktivitetet e ndryshme të kësaj natyre janë realizuar vazhdimisht në çdo degë të Forumit Rinor Islam. Ndër to mund të përmendim: "A e ka mposhtur e keja të mirën?", takimi me bursistët, "Orientimi profesional", "Ramazani, shkolla edukative", "Ramazani, muaji që takon zemrat me imanin", "Vlera e Muhamedit (alejhi selam) si shokë" etj.



PËRKUJTUES NË RRJETET SOCIALE

Zyra për marrëdhënie me publikun pranë FRI në mënyrë të vazhdueshme në rrjetet sociale ka shpërndarë përkujtuesit "Salavati i ditës së Xhuma", urime për ditë të veçanta kombëtare dhe fetare, urime për Hixhretin, letra ngushëlluese, përkujtuesit (lutjet) e iftarit gjatë muajit të Ramazanit, numërimi mbrapsht për Ramazan, përkujtues për tre ditët e bardha. Gjithashtu ZMP pranë FRI këtë vit vendosi që të zgjerohet edhe në rrjetin social TikTok.

KUVENDI I XV I FRI

Këtë vit u mbajt kuvendi i XV i Forumit Rinor Islam. Në këtë kuvend u zgjodh kryetari i ri i kuvendit, Liridon Ismaili, u bë prezantimi i raportit të aktiviteteve dhe raportit financiar.

Gjithashtu kuvendi votoi edhe disa ndryshime lidhur me rregulloren e brendshme të kuvendit.



VIZITA NËPËR INSTITUCIONE

FRI ka realizuar një numër të madh të vizitave nëpër institucione të ndryshme, edhe atë:

Komuna e Gostivarit, Komuna e Studeniçanit, Komuna e Likovës, Komuna e Çairit.



KUVENDI RAPORTUES I FRI – DEGA NË TETOVË

FRI – dega në Tetovë mbajti kuvendin raportues për vitin 2021.

Në këtë aktivitet u bë raporti i aktiviteteve të FRI – dega në Tetovë për vitin 2021 nga kryetari i degës, të cilin raport e miratoi kuvendi.



FRI SHËNON DITËN BOTËRORE TË MBULESËS

Forumi Rinor Islam edhe këtë vit shënoi Ditën Botërore të Mbulësës në Çarshinë e Vjetër të Shkupit.

U bë shpërndarja e fletushkave me çokollada për mbulesën me thënie për vlerën dhe rëndësinë e saj si dhe kalimtarët e rastit kishin mundësinë të provojnë shaminë dhe të fotografohen në kornizën e përgatitur enkas për ta shënuar këtë ditë.



AKSIONI “SHPËTO JETË, DHURO GJAK”

FRI – dega në Kërçovë realizoi aktivitetin tradicional “Shpëto jetë, dhuro gjak” gjatë fundjavës së dytë të marsit. Këtë herë ky aktivitet u realizua si nevojë që u paraqit pas pandemisë me Covid-19. Ky aktivitet që realizon FRI në bashkëpunim me Institutin e Transfuziologjisë dhe Kryçin e Kuq është nga më të suksesshmit e llojit të vet.



MIRËNJOHJE PËR SHKOLLAT SHQIPE

Me rastin e 7 Marsit, Ditës së mësuesit Forumi Rinor Islam dhuroi mirënjohje për disa shkolla fillore dhe të mesme në Shkup në të cilat ndiqet mësimi në gjuhën shqipe. Shpërndarjen e mirënjohjeve e bënë anëtarët dhe aktivistët e FRI në shenjë falënderimi për punën që ato po bëjnë.



FRI SHËNOI DITËN E MËSUESIT

Dita e mësuesit, 7 marsi këtë vit nga Forumi Rinor Islam u shënuar me një panel diskutimi në hapësirat e sallës së Komunës Çair në Shkup. “Arsimi në shkollat shqipe, sfidat dhe e ardhmja” ishte tema e cila u elaborua para shumë nxënësve, studentëve dhe arsimdashësve nga panelisti prof. Naser Miftari.



KAMPINGU DIMËROR NGA FRI – DEGA NË KUMANOVË

FRI – dega në Kumanovë realizoi kamping me aktivistët dhe anëtarët e kryesisë së degës gjatë fundjavës së parë të marsit. Ato kaluan së bashkë fundjavën në Kodrën e Diellit ku patën një numër të madh të aktiviteteve të përbashkëta me karakter edukativ.



FRI - DEGA TETOVË, REALIZOI TRAJNIM PËR SKIJIM

Forum Rinor Islam – Dega në Tetovë realizoi me sukses trajnimin tre ditorë për skijim, në kodrën e Diellit.

Gjatë tre ditëve (2, 3 dhe 4 Shkurt) kandidatët që u pranuan pas aplikimit për pjesëmarrje në këtë aktivitet, ndoqën trajnimin e skijimit, duke filluar nga niveli fillestarë. Trajnues në këtë aktivitet ishte prof. Orhan Sabrii.



MOZAIKU RINOR

Njëri nga aktivitet kryesorë të Forumit Rinor Islam për këtë vit ishte "Mozaiku rinor". Ky projekt në vete ngërthen 4 nën-projekte:

- Projekti "Eureka". U realizua me nxënësit e klasave të nënta në të gjitha degët e Forumit Rinor Islam dhe ka për qëllim edukimin e përgjithshëm dhe formimin e personalitetit.

- Projekti "Incept". U realizua me nxënësit e viteve të para të të gjithë qyteteve ku FRI funksionon dhe ndër qëllimet kryesorë ka zgjidhjen e problemeve ndërpersonale të adoleshentëve.

- Projekti "Talentium". U realizua me nxënësit e viteve të treta dhe qëllim kryesor ka edukimin meditativ të nxënësve, si dhe përgatitjen e tyre profesionale.

Pjesë e këtyre projekteve nuk ishin vetëm trajnimet, që në vete ishin shumë atraktive për pjesëmarrësit, por edhe vizitat dhe shëtitjet që nuk ishin të pakta. Pjesëmarrësit u ndanë me nga një certifikatë për projektin që kanë përfunduar.







“ORIENTIMI PROFESIONAL”

FRI – dega në Shkup realizoi takimin “Orientimi profesional” me shkollarët e mesëm nga qyteti i Shkupit. Takimi u realizua në ambientet e universitetit IBU, dhe ligjërues ishin prof. Musa Musai dhe Emir Fetai. Njëashtu pjesë e takimit ishte edhe zëvendës rektori i IBU - së, prof. Mevludin Ibish i cili prezantoi para të pranishmëve programet që ofron Universiteti i Ballkanit.



KAMPINGU VEROR NË FSHATIN PATISHKË

Një aktivitet rekreativ që u realizua me pjesëmarrëset e projekteve “Motivi” dhe “Mesazhi” të realizuara nga FRI – dega në Shkup. Përveç aktiviteteve të lira, u realizua edhe një ligjërata, “Vlerat e një muslimaneje”, nga teologja Esmâ Sherif Kurti.



AKADEMIA RINORE “MENDIMI”

Ky projekt apo akademi rinore, përbëhet nga tre projekte, “Gjurmët” (niveli i parë), “Motivi” (niveli i dytë) dhe “Mesazhi” (niveli i tretë). Akademia Rinore “Mendimi” në esencë ka të bëjmë me edukimin e të rinjve të cilët ndjekin trajnimet apo ligjëratat në këtë akademi që është zgjat për një periudhë më të gjatë. Ky aktivitet u realizua në shumicën e degëve të Forumit Rinor Islam, ku pjesëmarrësve ju ndanë mirënjohje për nivelin (projektin) e përfunduar.




RAMAZANI, MUAJI I PËRKUSHTIMIT

- Aktiviteti "Mirë se erdhe Ramazan" u realizua në qytete të ndryshme duke shpërndarë dhurata bashkë me fletëurime dhe këshilla për muajin e Ramazanit.
- Sfida "Mësimi i sures Fexhr" ishte një aktivitet që synonte mësimin përmendësh të sures Fexhr, ku për çdo ditë të muajit Ramazan u ndanë dy ajete nga kjo sure nëpërmjet grupit të formuar në Telegram.
- "Shporta e Ramazanit" u realizua edhe këtë vit në degët ku funksionon Forumi Rinor Islam, nëpërmjet të cilit aktivitet u bë shpërndarja e mjeteve ushqimore dhe higjienike për nevojtarët.
- "Melhemet e Ramazanit" ishte një aktivitet që u paraqit në rrjetet tona sociale. Figura të dalluara nga trojet tona përçuan mesazhet e tyre nëpërmjet videoeve që u paraqitën para publikut tonë.
- FRI realizoi një numër të madh të iftareve në të gjithë degët, përfshirë këtu iftare me nxënës, studentë, profesorë, aktivistë, anëtarë të degëve, pjesëmarrës në projektet rinore, bursistë, personalitete të ndryshme, anëtarë të komuniteteve të ndryshme.





- U realizua një numër i madh i mbrëmjeve Kuranore, edhe atë: Mbrëmja Kuranore në Saraj, në sheshin "Isa Boletini", në Haraçinë, Kërçovë, në Çarshinë e Vjetër të Shkupit,
- "Opinione Ramazani" ishte gjithashtu një aktivitet që u realizua nëpërmjet rrjeteve sociale, ku personalitete të ndryshme ndanin opinionet e tyre rreth muajit të Ramazanit.
- "Hadithi im i preferuar", një aktivitet tjetër i transmetuar nëpërmjet ekraneve teknologjike, ku të rinjtë treguan hadithin e tyre të preferuar.
- Kuizi i diturisë "Ikre" u realizua nga FRI – dega në Prilep. Ky aktivitet që në vete ka karakter garues realizohet me qëllim të promovimit të diturisë dhe përfitimit të njohurive të reja për nxënësit.
- "Gëzuar Fitër Bajramin" është videoja që realizohet në fund të muajit të Ramazanit dhe kryetari përcjellë mesazhin e tij për Bajram nëpërmjet rrjeteve sociale.
- Kokteji i Bajramit në Shkup – u realizua në vigjilje të Fitër Bajramit me pjesëmarrëset e projekteve të realizuara nga FRI – dega në Shkup. Aktiviteti filloi me leximin e ajeteve të Kuranit Famëlartë dhe ndër të tjera u begatua edhe me një ligjëratë nga teologja Esmë Sherifi Kurti.



FRI – DEGA NË KËRÇOVË VIZITË NË SHQIPËRI

Nxënësit që ndoqën projektet rinore në qytetin e Kërçovës patën mundësi që të kalojnë disa ditë në Republikën e Shqipërisë, ku ato realizuan një numër të madh të vizitave. Ndër të tjera ato vizituan: Parkun e Liqenit në Tiranë, xhaminë e Et'hem beut, xhaminë e Namazgjasë, malin Dajt, qendrën e Tiranës, Kalanë e Krujës, qytetin e vjetër të Krujës, qendrën e shoqatës "Ardhmëria" në Tiranë dhe konviktet e shoqatës "Mirësia".



KONCERTI I BAJRAMIT NË KUMANOVË

Me rastin e festës së Bajramit, FRI – dega në Kumanovë në bashkëpunim me shoqatën edukative "Vllaznia" realizoi koncertin e Bajramit në sheshin e qytetit të Kumanovës. Kryefjalë e këtij aktiviteti ishte leximi i Kuranit Famëlartë dhe i ilahive nga recitues të mirënjohur.



VIZITË NË QYTETIN E ÇANAKALASË

Aktivistët dhe nxënësit më të dalluar nga projektet rinore të “Mozaikut rinor”, të cilët u përzgjedhën nga përgjegjësit e projekteve në të gjitha degët, morën pjesë në shëtitje në Çanakale. Bashkë me ato, nën përkujdesjen e bashkisë së Çanakalasë, u vizituan vendet historike të luftës, për të parë historinë tonë të përbashkët. Vizituan qytetin dhe qendrën e qytetit duke kaluar kohë pranë bregdetit. Kjo shëtitje u realizua me qëllim që të mësojnë duke shëtitur dhe të mundësojmë një ambient rinor për aktivistët tanë, ashtu që t'i motivojmë ato.





BURSAT STUDENTORE

Gjatë vitit akademik 2022/23 Forumi Rinor Islam ndau bursa për një numër të madh të nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve.



FRI MIRËPRITI FEMYSO

Me datë 01.07.2022, Forumi Rinor Islam mirëpriti organizatën rinore FEMYSO - Forum Of European Muslim Youth And Student Organisation.

Përgjatë takimit u prezantuan aktivitetet e të dyja palëve të realizuara përgjatë viteve të fundit nga nënkryetarja e FRI-së, Zuljeta Fetaj dhe përgjegjësjë për lidhjet me organizatat anëtare të FEMYSO-së, Nadia El Faroukhi.

SHKOLLA EDUKATIVE "HAXHI NAZIM XHAFFERRI"

Shkolla edukative joformale "Haxhi Nazim Xhaferri" që ka filluar me veprimtarinë në qytetin e Kërçovës, në vitin 2021 ka vazhduar me aktivitete të shumta edhe në vitin 2022. Veprimtarie e kësaj shkolle fokusohet në mësimin e Kuranit dhe mësimbesimit, si dhe mësimin e gjuhëve të huaja. Nxënësit e shkollës edukative realizojnë një numër të madh të aktiviteteve tjera, sidomos gjatë muajit të Ramazanit, që është një mundësi e rrallë për to.

BËHU PJESË E SHKOLLËS EDUKATIVE "HAXHI NAZIM XHAFFERRI"

Forum Rinor Islam - dega në Kërçovë ju fton të bëheni pjesë e shkollës edukative "Haxhi Nazim Xhaferri". Nëse jeni nxënës i shkollës fillore dhe doni të mësoni në këto dy sfera:

1. Kuran (mësimi shkronjave, lexim, përforsim)
2. Etikë, kulturë dhe mësim-besim

TAKIMI RINOR BALLKANIK “RINIA PËRBALLË KRIZAVE – NDËRVEPRIMI DHE ZGJIDHJET”

Para fillimit të vitit të ri akademik 2022/23 në qendrën e FRI - së në Shkup u realizua Takimi Rinor Ballkanik - “Rinia përballë krizave - ndërveprimi dhe zgjidhjet” ku pjesëmarrës ishin të rinj nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Presheva, Sanxhaku dhe Maqedonia e Veriut. Gjatë këtij takimi u realizuan një sërë trajnimesh dhe ligjëratash së bashku me shumë aktivitete tjera. U bë prezantimi i një numri të madh të OJQ dhe shoqata kulturore “Dituria” – Preshevë u përzgjedh për vendin e parë. Pjesëmarrësit u ndanë me nga një mirënjohje dhe dhuratë simbolike.



**TAKIMI RINOR BALLKANIK
"RINIA PËRBALLË KRIZAVE –
NDËRVEPRIMI DHE ZGJIDHJET"**



NË SHKUP U BË PËRURIMI I QENDRËS EDUKATIVE RINORE

Ndër momentet më të rëndësishme të organizatës sonë është hapja e Qendrës Edukative Rinore në Shkup, objekt ky i cili do të jetë në shërbim dhe dobi të shumë aktiviteteve rinore si dhe të të gjithë të rinjve të cilët kanë dëshirë të zhvillojnë kapacitetet e tyre. Hapja solemne u fillua me leximin e disa ajeteve nga Kurani Famëlartë. Fjalë rasti pati kryetari i FRI-së, mr. Xhabir Emini; përfaqësuesi i fondacionit IHH nga Republika e Turqisë, Jusuf Bilgin, fondacion ky i cili ndihmoi në ndërtimin e këtij objekti; përfaqësuesi i të rinjëve në këtë fondacion, Vahab Jollxhu, ish kryetari i Forumit Rinor Islam, Fisnik Shabani si dhe kryetari i Fondacionit Axis, Rufat Sherifi.

Të gjithë donatorëve dhe atyre që kontribuan iu dhurua nga një pllaketë në shenjë falenderimi për kontributin e tyre. Programi përfundoi me një lutje të bërë nga hoxha Sabaudin Jashari.



“NË GJURMËT E MË TË MIRËVE” – HIXHRI 1444


Për të 22-tën herë me radhë Forumi Rinor Islam realizoi manifestimin tradicional “Në gjurmët e më të mirëve”, që realizohet me rastin e Vitit të Ri Islamik.

Manifestimi i këtij viti u realizua në Teatrin Kombëtar Maqedonas. Në këtë event FRI shfrytëzon rastin të përçojë mesazhet kuranore dhe të promovojë vepra artistike, por vëmendja e këtij organizimi është ndarja e mirënjohjeve, çmimeve dhe shpërblimeve në disa kategori, ndër të cilat më kryesorja është shpallja e studentëve më të mirë.





FORUMI RINOR ISLAM

Rr. Cairska nr.1, 1000 Shkup 
Maqedonia e Veriut

info@fri.org.mk 

www.fri.org.mk 